

RELACIONI

PROJEKT LIGJ

“PËR RININË”

Prej disa kohësh tashmë në Shqipëri është ndjerë një reagim i fuqishëm nga studentët dhe të rinjtë shqiptarë në lidhje me zbatimin e të drejtave të tyre dhe njëkohësisht me mundësitë që Shqipëria u ofron për të ndërtuar të ardhmen e tyre.

Në këtë kuadër dhe njëkohësisht falë punës së pandërprerë dhe intensive që kanë bërë grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile është parë e nevojshme hartimi i një kornize ligjore që nderhyn dhe rregullon disa aspekte të angazhimit rinor.

Shqipëria ka bërë një sërë përparimesh për të sjellë legjislacionin shqiptar më afër standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si të OKB-së ashtu edhe të Këshillit të Europës. Po në këtë linjë është zhvilluar edhe legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, grave, minoriteteve apo grupeve të tjera të marginalizuara.

Megjithatë, pavarësisht të gjitha këtyre zhvillimeve pozitive në fushën e legjislacionit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut, zhvillimi i të drejtave të të rinjve ka mbetur i kufizuar dhe përgjithësisht ka mbetur i lidhur me të drejtën e adoleshentëve dhe të rinjve për arsim, punësim apo mbrojtjen nga diskriminimi.

Në të njëjtën kohë, paralelisht me zhvillimet në Shqipëri, në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë në vendet e Bashkimit Europian, legjislacioni për Rininë është zhvilluar dhe sot ka eksperiencë pozitive thuajse në çdo vend Europian. Një pjesë e vendeve kanë ligje që rregullojnë të gjithë marrëdhëniet me rininë, ndërsa një pjesë tjetër kanë ligje që lidhen me rregullimin e punës me të rinjtë, si një aktivitet, por edhe profesion që ndihmon në fuqizimin dhe organizimin e të rinjve.

Shqipëria ka patur zhvillime pozitive që prej vitit 1998 e në vijim në drejtim të përgatitjes dhe zbatimit të Strategjisë së Rinisë apo planeve kombëtare të veprimit. Strategjitë e rinisë kanë patur tendencën që të rregullojnë të gjitha fushat shqetësuese për të rinjtë, duke vendosur prioritetet strategjike për të sjellë ndryshimet e pritshme për të rinjtë, kudo ata jetojnë në Shqipëri. Në vitin 2015, Qeveria shqiptare miratoi Planin Kombëtar për Rininë (2015-2020), një plan ambicioz i bazuar në 6 objektiva madhorë dhe mbi 100 aktivitete në mbështetje të rinisë.

Në Gusht 2018, Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë dhe CRCA Shqipëri, publikuan raportin “Rinia në Shqipëri”, i cili realizoi një monitorim të plotë dhe të pavarur të Planit Kombëtar për Rininë dhe nivelit të zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara në plan. Gjetjet më kryesore të Raportit ishin:

1. Vetëm rreth 21% e Planit të Veprimit për Rininë ishte zbatuar deri në fund të vitit 2017! Plani i Veprimit nuk është zbatuar në tërësinë e tij dhe sipas objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara për t'u përmbushur gjatë periudhës 2015-2016. Nga 48

aktivitete të parashikuara për t'u realizuar gjatë kësaj periudhe, vetëm 10 prej tyre ishin përmbushur.

2. Papunësia është një ndër problemet madhore me të cilat përballet Rinia në Shqipëri dhe kjo rrit tendencën e të rinjve për të emigruar nga vendi. Rreth 26% e të rinjve aktualisht janë të papunë, ndërkohë që djemtë kanë nivel më të lartë papunësie sesa vajzat;
3. Thuajse 50% e të dënuarve për krime në Shqipëri i përkasin moshës 15-30 vjeç. Vendi nuk ka asnjë politikë sociale apo të drejtësisë për grup-moshën 21-30 vjeç. Mungesa e nismave dhe mekanizmave për organizimin dhe Fuqizimin e të rinjve, sidomos në zona ku papunësia dhe përjashtimi social janë më të përhapura, nxit sjelljen anti-sociale dhe kriminalitetin rinor;
4. Mungesa e buxhetit specifik për rininë në Buxhetin e shtetit dhe në atë të Bashkive, shikohet si një ndër faktorët kryesorë që ka ndikuar në apatinë dhe mungesën e angazhimit të të rinjve në politikë, vendim-marrje dhe në nisma vullnetare;
5. Po në këtë drejtim, Pjesëmarrja e të rinjve në proceset vendim-marrëse është shumë e ulët. Raporti tregoi se rreth 73% e të rinjve, nuk kanë gjetur mbështetjen e Qeverisë dhe Bashkive në përfaqësimin e tyre në proceset vendim-marrëse dhe strukturat e qeverisjes vendore. Referuar raportit “të rinjtë ndiejnë se po përdoren vetëm si një sfond politik, nuk kanë pjesëmarrje efektive në politikë-bërje dhe vendim-marrje në të gjitha nivelet e politikës si dhe kanë një mungesë të theksuar të mbështetjes së saj;
6. Mbi 80% e të rinjve në mbarë vendin pohojë se ka një mungesë të theksuar të shërbimeve miqësore dhe cilësore për ta. Këshillimi dhe ndihma psiko-sociale falas për gjimnazistët dhe studentët nuk ofrohet në asnjë qytet të Shqipërisë, ndërsa ky shërbim duhet ofruar në Qendrat Komunitare ose Rinore të Bashkive.

Nisur nga roli që shteti luan në këtë drejtim, ne propozojmë miratimin e Ligjit për Rininë në Shqipëri, duke u bazuar në argumentet e mëposhtëm:

1. Prioritizimi i çështjes se rinisë dhe të të drejtave të tyre në Shqipëri

Të rinjtë përbëjnë një nga grupet kryesore shoqërore në vend. Megjithatë në kuadër të gëzimit të të drejtave, ata bien ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve. Kjo mbi-vendosje moshore ka sjellë jo pak probleme në drejtim të gëzimit të të drejtave dhe kujdesit që ata duhet të gëzojnë si grup shoqëror. Në këtë kuadër shteti shqiptar është munduar ta rregullojë këtë mangësi duke zhvilluar strategji dhe politika publike për të rinjtë.

Megjithatë siç kanë treguar vlerësimet e pavarura që i janë bërë zbatimit të politikave, ato nuk kanë arritur të sjellin ndryshimet e pritshme të parashikuara në planet e veprimit dhe politikat rinore. Në këtë aspekt, mendohet se miratimi i një ligji për rininë, do t'i jap vëmendjen që kërkohet çështjes dhe të drejtave të të rinjve, duke zgjidhur më së fundi edhe nivelet e përgjegjësisë që kanë institucionet publike përkundrejt të rinjve dhe të rejave në Shqipëri.

2. Përcaktimi se kush konsiderohet i ri / e re në Shqipëri

Projekti i propozuar zgjidh ndër të tjera edhe pikëpyetjen se kush konsiderohet i ri / e re në Shqipëri, bazuar në rekomandimet e OKB-së dhe të Këshillit të Europës. Konventat dhe aktetet ndërkombëtare të OKB-së dhe të Këshillit të Europës, ia kanë lënë në dorë vendeve antare përcaktimin e moshës, për shkak se vende të ndryshme kanë rregullime të ndryshme në këtë drejtim. Meqënëse Shqipëria nuk ka patur një ligj më të hershëm për të rregulluar këtë aspekt, projekt-ligji i propozuar bën të mundur rregullimin dhe përkufizimin e faktit se kush do të konsiderohet i ri / e re dhe që do të përfitojë nga zbatimi i ligjit.

3. Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi në nivel qendror dhe vendor për rininë dhe mekanizmeve të zbatimit të ligjit

Ndër të tjera projekt-ligji i propozuar ndërton një arkitekturë të re për rininë në Shqipëri, duke riorganizuar dhe fuqizuar atë ekzistuese që ekziston sot për të rinjtë. Në opinion e ekspertëve, një ndër shkaqet pse çështjet e të rinjve nuk kanë arritur të gjenerojnë një përfshirje të gjerë të të rinjve, në proceset politikë-bërëse, sociale, kulturore, arsimore dhe ekonomike në Shqipëri është nga njëra anë, mungesa e mekanizmave përgjegjës për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve dhe, nga ana tjetër, mungesa e instrumenteve që garantojnë të drejtat e të rinjve.

Nisur nga kjo, projekt-ligji propozon ngritjen e një arkitekture të thjeshtë vertikale dhe horizontale për të rinjtë, ku ata vendosen në qendër të pjesëmarrjes rinore në këto struktura. Nga ana tjetër, duke marrë në konsideratë mangësitë që janë vërejtur në zbatimin e ligjeve të përafërta, ne kemi propozuar rinorganizimin dhe fuqizimin e mekanizmave ekzistues si në nivel qendror ashtu edhe atë vendor.

Po në këtë kuadër ne kemi propozuar krijimin e një pozicioni të ri në nivel kombëtar, atë të Koordinatorit Kombëtar për Rininë, që në kuadrin aktual korrespondon me pozicionin e zv. Ministrit në Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë. Ky ri-organizimin jo vetëm që fuqizon rolin, por i jep atij vlera të reja, duke i caktuar detyra e përgjegjësi të mbështetura tashmë në ligj.

E fundit që vlen të theksohet është që ligji i cakton përgjegjësi Qeverisë dhe Bashkive që ata çdo vit të planifikojnë burimet financiare që duhen për të bërë të mundur zbatimin e ligjit. Në këtë kuadër projekt-ligji kërkon nga çdo institucion që të ketë një buxhet të veçantë për rininë dhe mbështetjen e punës me të rinjtë. Në parim, kjo zgjidh edhe një ndër ngërçet tradicionale të mungesës së buxhetit për zbatimin e ligjeve dhe politikave të lidhura me to.

4. Garantimi i të drejtave të të rinjve për të marr pjesë, për t'u përfaqësuar dhe për tu organizuar

Projekt-ligji për rininë në Shqipëri bazohet në eksperiencat më të mira ligjvënës në vend, si ligji për barazinë gjinore, ligji për mbrojtjen nga diskriminimi etj. Në këtë aspekt projekti i propozuar fokusohet në rikonfirmimin e disa të drejtave bazë për të rinjtë, sidomos të të drejtave politike dhe social-kulturore. Ndër të drejtat politike të garantuara nga ligji është përfshirë e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhjet kombëtare dhe shprehja e mbështetjes për kuotat rinore, të cilat garantojnë një minimum të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në proceset vendim-marrëse. Po ashtu ligji garanton të drejtën e organizimit dhe të pjesëmarrjes të të rinjve në institucione dhe organizata rinore dhe mbështetjen për to.

Në drejtim të të drejtave social-kulturore projekt-ligji fokusohet në nxitjen dhe ofrimin e shërbimeve për të rinjtë nëpërmjet Qendrave rinore dhe profesionistëve për të rinjtë, siç është rasti i punonjësit rinor. Ndonëse ngritja e Qendrave rinore është një proces që ka filluar që prej vitit 2015, tashmë ngritja dhe mbështetja e tyre kthehet në një përgjegjësi të bashkive. Po ashtu ligji zgjidh edhe rolet dhe funksionet që duhet të luajnë Qendrat Rinore në drejtim të pjesëmarrjes dhe fuqizimit të të rinjve dhe të rejave në Shqipëri.

5. Kostot financiare

Projekt-ligji i propozuar nuk ka kosto financiare. Zbatimi i tij do të bëhet nga burimet aktuale të Ministrisë përgjegjëse, ministrive të linjës dhe fondeve të organeve të qeverisjes vendore.

6. Përputhja e akteve me *Aquis*

Projekt-ligji i propozuar është në përputhje të plotë me direktivat e Bashkimit Europian në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve. Ndryshimet e propozuara në këtë projekt-ligj përforcojnë zbatimin dhe përputhshmërinë e tyre me normat e *Aquis Communautaire*. Vetë ligji është ndërtuar në eksperiencat më të mira të ligjeve të njëjta ose të përafërta me tonin, si Irlanda, Bullgaria, Holanda apo Gjermania.